



## Apel të përmbaheni nga udhëtimet

Shifrat e të infektuarve në Heilbronn vazhdojnë të jenë të larta. Për të ulur numrin e infektimit dhe për të mos e mbingarkuar sistemin tonë të shëndetësorë, ju lutem me këmbëngulje të respektoni rregullat aktuale të urdhëresës për koronën. Gjithashtu, do t'ju lutesha të reduktoni kontaktet tuaja personale dhe t' i përmbaheni të ashtuquajturës formula AHA (**A**bstand-**H**ygjene-**A**lltagsmaske; ruani distancën, respektoni higjienën, mbani maska mbrojtëse). Mbroni veten dhe të tjerët.

**Ne ju bëjmë thirrje urgjente: Mos udhëtoni gjatë pushimeve të krishtlindjeve, edhe nëse keni planifikuar të kryeni vizita edhe nëse koha e përbashkët me familjen është e rëndësishme për ju.**

Në rast se ju ktheheni sërish në Gjermani nga një zonë rreziku, ju duhet të hyni menjëherë në karantinë për 10 ditë. Kjo do të thotë, gjatë kësaj kohe ju nuk duhet të largoheni nga banesa dhe nuk lejohet të prisni vizita. Përveç kësaj, gjatë periudhës së karantinës ju nuk keni të drejtë page/rroge nga punëdhënësi juaj. Shkelja e rregullave të urdhëresës së koronës, mund të çojë në gjoba prej disa mijëra Eurosh.

Informacione të mëtejshme, mbi kthimin nga një zonë rreziku, do të gjeni në [www.heilbronn.de/coronavirus](http://www.heilbronn.de/coronavirus) nën titullin “Informacione mbi kthimin nga një zonë rreziku”.

Urdhëresën aktuale mbi rregullat e koronës, në gjermanisht dhe në gjuhë të tjera, do ta gjeni këtu <https://www.baden-wuerttemberg.de/de/service/aktuelle-infos-zu-corona/aktuelle-corona-verordnung-des-landes-baden-wuerttemberg/>.